



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. të datës 19.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. e datës 19.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Harst Group Sh.P.K. për pozitën e inxhinierit të termoenergjetikës ka prezantuar z. Shkëlqim Alidema i cili është Bachelor dhe Master i Termoenergjetikës. Arsyeya pse jemi konsideruar si të papërgjegjshëm është kinse ka vetëm 4 vite përvojë pune pas diplomimit (dhe jo 5 siç është kërkuar me DT). Por duke u bazuar në kërkesat e DT ku shihet qartë se kërkesa është Bachelor apo Inxhinier i diplomuar, atëherë ju njoftojmë se Inxhinieri i propozuar ka mbi 5 vite përvojë pune pas diplomimit të nivelit bachelor me ç'rast plotësohen edhe kërkesat e DT. Në CV që është prezantuar shihet qartë se Inxhinieri në fjalë ka mbaruar studimet të nivelit Bachelor në vitin 2016, po ashtu duke përdorur logjikë të thjeshtë një person që ka përfunduar masterin në vitin 2019 atëherë automatikisht i bie që studimet e bachelorit i ka përfunduar minimum dy vite më herët. Bashkangjitur gjeni diplomën e bachelorit. Po ashtu edhe partneri i konsorciumit ka në listë të punësuar si inxhinier të makinerisë Z. Arlind Krasniqi i cili ka mbi 8 vite përvojë pune por për të cilin ju nuk keni shprehur vullnet që të kërkonte sqarime shtesë. Dëshmi dokumentacioni për inxhinierin".

Për shkak të këtyre pretendimeve të cituara si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet pretendimi ankimor është kërkesa e dytë në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - 9.1 & 9.2) e cila është përcaktuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<u>Kapaciteti teknik dhe profesional</u> 2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme Udhëheqës i punishtes - Bachelor apo Inxhinier i dip. i termenergjetikës - 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 3 punëtor fizik	<u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u> 2.CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes (Inxhinieritn e Termo-Energjetikës). Kontratat për punëtorët fizik si dhe lista prej ATK
---	-----------	--	---

Tutje sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, arsyet për eliminimin e parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm janë përcaktuar si në vijim "në ofertën e dorëzuar te kualifikimet shkollore te udhëheqësi i punishtes nuk posedon 5 vite përvojë pune siç është cekur te kriteret në dosje të tenderit pasi që diplomimi i tij është në 17 qershor 2019 që nuk i mbushë 5 vite përvojë pune deri me sot".

Nga dosja me të cilën ka ofertuar parashtruesi është gjetur se lidhur me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit është dorëzuar CV për z. Shkëlqim Alidema si dhe diploma e masterit e datës 17 qershor 2019. Nga raporti i vlerësimit është gjetur se përvoja e punës pas diplomimit është marrë për bazë nga data e përfundimit të studimeve master dhe jo nga data e përfundimit të studimeve themelore (Bachelor). Sa i përket faktit që parashtruesi nuk ka dorëzuar diplomën bachelor së bashku me ofertë, komisioni vlerësues për të vërtetuar thëniet në CV e dorëzuar nga parashtruesi ka pasur mundësi që të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 38 të RRPP.

Duhet theksuar që parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim ka bashkangjitur edhe diplomën bachelor për z. Shkëlqim Alidema të datës 13 shtator 2016. Këtë fakt komisioni vlerësues nuk ka arritur që të evidentoj dhe të vlerësoj këtë fakt me rastin e krahasimi dhe vlerësimit të tenderëve. Ky mosveprim nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit janë të bazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.08.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.